



VENDIM

Nr. 18, Datë 31.01.2017

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E KONTRATËS PËR SHIT-BLERJEN E ENERGJISE ELEKTRIKE NDËRMJET KESH SH.A. DHE OSHEE SH.A PËR TEPRICAT E ENERGJISË ELEKTRIKE, PËRFSHIRË TEPRICAT NË KUSHTET E PRURJEVE TË MËDHA, ME QËLLIM PLOTËSIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN E SHPËRNDARJES PËR PERIUDHËN KOHORE 01.01.2017-31.12.2017

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, Nenin 5 pika 4 të VKM nr. 244 dt.30.03.2016, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, që ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96 datë 23.06.2016, Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 31.01.2017 pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të ERE për fillimin e procedurës për miratimin e Kontratës për shit-bletjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2017-31.12.2017,

Konstatoi se:

- Me vendimin e Bordit të ERE Nr. 174, Datë 07.11.2016 është vendosur miratimi i kontratës/marrëveshjes për shit-bletjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.07.2016-31.12.2016,
- Shoqëria “OSHEE sh.a.” me shkresën nr. 31126 prot, datë 23.12.2016 i ka përcjellë shoqërisë KESH sh.a. për nënshkrim Kontratë/marrëveshjen për shit-bletjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me

qëllim plotësimit e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2017-31.12.2017.

- Shoqëria “KESH sh.a.” nëpërmjet shkresës nr. 88 Prot, datë 09.01.2017 I ka përcjellë shoqërisë OSHEE sh.a. për nënshkrim Kontratë/marrëveshjen për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimit e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2017-31.12.2017.
- Kjo kontratë me nr identifikimit Prot i KESH sh.a. 87 datë 09.01.2017 dhe prot i OSHEE sh.a. 1306 datë 17.01.2017 është nënshkruar nga të dyja palët.
- U konstatua se ndryshimet në këtë marrëveshje, referuar përmbajtjes së marrëveshjes miratuar me herët me vendimin Nr. 174, Datë 07.11.2016 të Bordit të ERE, janë vetëm në funksion të përditësimit të kuadrit ligjor rregullator të miratuar më herët nga ERE me vendimin e sipërcituar.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi :

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e Kontratës/Marrëveshjes për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimit e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2017-31.12.2017.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet Ankim në Gjykatën Administrative brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare .



Votimi i Bordit të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 18, Datë 31.01.2017

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
KONTRATËS PËR SHIT-BLERJEN E ENERGJISE ELEKTRIKE
NDËRMJET KESH SH.A. DHE OSHEE SH.A PËR TEPRICAT E
ENERGJISË ELEKTRIKE, PËRFSHIRË TEPRICAT NË KUSHTET E
PRURJEVE TË MËDHA, ME QËLLIM PLOTËSIMIN E HUMBJEVE NË
RRJETIN E SHPËRNDARJES PËR PERIU DHËN KOHORE 01.01.2017-
31.12.2017**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Petrit Ahmeti	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Maksim Shuli	_____	_____